PROCEDURA PER DHENIEN E LICENCA VE PER TREGTIMIN ME PAKICE TE KARBURANTEVE, GAZIT TE LENG-SHEM TE NAFTES, PER AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LENDEVE DJEGESE PER PERDORIM NGA KONSUMATORET FUNDORE

Per marrjen e licencave per funksionirnin e stacioneve te shitjes se karburanteve, gazit te lengshem te naftes per automjete e vajrave lubrifikante, personi juridik duhet te paraqese:

- Ekstraktin historik dhe tregtar te regjistrit tregtar, nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, ku te kete te percaktuar veprimtarine e tregtimit te nenprodukteve te naftes bruto;
- Vertetimin per kontrollin e objektit, per respektimin e kushteve teknike, te leshuar nga Inspektorati Shteteror Pergjegjes;
- Certifikaten e kalibrirnit te rezervuareve, te vendosur ne stacion, dhe te matjes se aparateve te shitjes se karburanteve dhe gazit te lengshem te naftes, nga DPM-ja ose organet e autorizuara per kete qellim;
- Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit ne fuqi per mjedisin;
- Autorizirnin hyrje-dalje ne rruge, te leshuar nga enti pronar i rruges;
- Regjistrimin e markes tregtare prane Drejtorise se Pergjithshrne te Markave dhe Patentave;
- Vertetirnin e shlyerjes se detyrirneve vendore;
- Vertetirnin e shlyerjes se detyrirneve tatimore, perfshire sigurimet shoqerore.

Perseritja e licensave behet nga organi qe ka dhene licensen, kundrejt nje kerkese te personit juridik, e cila shqyrtohet njesoj si nje kerkese e re, duke paraqitur dokumentet e percaktuara ne shkronjat "a","ç " , "d ", "dh " , "e", “ë”, “f” dhe "g", te pikes 2, te ketij kreu.